

O R I O N SH.P.K.

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË	5
SHËNIME TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 17

ORION SH.P.K.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014
(Vlerat janë në Lekë)
**Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor 2014**

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	5,601,946	11,335,261
Llogari të arkëtueshme	5	1,652,154,025	1,373,297,976
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	6	30,000	60,644,535
Inventari	7	15,286,800	29,195,174
Llogari të tjera arkëtueshme	8	283,306	283,306
Total Aktiveve Afatshkurtra		1,673,356,077	1,474,756,252
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale		35,383,375	30,060,141
Aktive afatgjatë jomateriale		17,265	20,312
Llogari të tjera të arkëtueshme		-	-
Total aktive afatgjatë	9	35,400,640	30,080,453
Total Aktive		1,708,756,717	1,504,836,705
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra		-	-
Llogari të pagueshme tregëtare	10	194,806,416	128,313,614
Parapagime të arketuara	11	899,837,043	783,781,097
Detyrime tatimore	12	2,769,946	3,586,053
Llogari të pagueshme të tjera	13	243,069,739	242,150,483
Total Detyrime afatshkurtra		1,340,483,144	1,157,831,247
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë		-	-
Tatimi i shtyre mbi fitimin		-	-
Grante, te ardhura të shtyra e të tjera detyrime		-	-
Detyrime nga qeraja financiare		-	2,309,938
Total Detyrime afatgjatë		-	2,309,938
Totali i detyrimeve		1,340,483,144	1,160,141,185
Kapitali themeltar			
Kapitali themeltar		39,000,000	39,000,000
Reduktim i paregjistruar i kapitalit		-	-
Rezerva të tjera		288,206,698	85,946,190
Rezerva ligjore		17,488,822	6,843,532
Fitime të mbartura		-	-
Fitimi i ushtrimit		23,578,053	212,905,798
Total kapitali	14	368,273,573	344,695,520
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,708,756,717	1,504,836,705

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ORION SH.P.K.

Pasqyra Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Te Ardhurave dhe Shpenzimeve

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Shënime	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga punime dhe shërbime	15	309,649,154	349,226,930
Te ardhura të tjera	15	253,590	205,525,698
Materiale të para dhe të konsumueshme	16	(252,399,542)	(285,291,491)
Shpenzime personeli	17	(13,282,019)	(13,342,608)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	18	(2,273,387)	(2,316,060)
Shpenzime të tjera	19	(13,807,564)	(13,386,944)
Fitimi operativ		28,140,232	240,415,525
Te ardhura/Shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara		-	-
Te ardhura/(Shpenzime) financiare Neto	20	(66,010)	(3,642,740)
Total shpenzime financiare		(66,010)	(3,642,740)
Fitimi para tatimit		28,074,222	236,772,785
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		-	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(4,496,169)	(23,866,987)
Fitimi i vitit	21	23,578,053	212,905,798

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ORION SH.P.K.**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Levizjeve të Kapitallit
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**

	Kapitali themeltar	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura /humbje të akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	39,000,000	77,508,167	6,399,425	8,882,130		131,789,722
Fitimi i vitit					212,905,798	212,905,798
Transferim në rezerva		8,438,023	444,107	(8,882,130)		-
Dividendë të paguar						-
31 Dhjetor 2013	39,000,000	85,946,190	6,843,532	-	212,905,798	344,695,520
Fitimi i vitit					23,578,053	23,578,053
Transferim në rezerva		202,260,508	10,645,290	-	(212,905,798)	-
Dividendë të paguar						-
31 Dhjetor 2014	39,000,000	288,206,698	17,488,822	-	23,578,053	368,273,573

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj pasqyre financiare.

Pasqyrat financiare të Shogërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori i ORION sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 30 Mars 2015 nga:

Ardian Nelo
Administrator




ORION SH.P.K.
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Fluksit të Parasë

Më 31 Dhjetor 2014

Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	28,074,222	236,772,785
Axhustime për zërat jo-monetare:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	2,273,387	2,316,060
Te ardhura nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale		
Nxjerrja jashtë përdorimit e Mjeteve fikseve, neto nga fitimi kapital		
Interesa te perlllogaritura		
Shpenzime për interesa		
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	30,347,609	239,088,845
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në inventar	13,908,374	(10,003,607)
Ndryshimi në llogari të arketueshme dhe të tjera	(278,856,049)	(268,961,104)
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	66,595,951	77,951,145
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra	60,614,535	19,364,228
Ndryshimi në parapagime të arketuara	116,055,946	
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	8,666,366	57,439,507
Interesa të paguara		
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(4,496,169)	(23,866,987)
	(4,496,169)	(23,866,987)
Aktivitetet investuese		
Blerje të aktiveve afatgjata material	(7,593,574)	(2,334,436)
Shitje të aktiveve afatgjata material		
Blerje të shoqërisë së kontrolluar minus parate të arketuara		
Interesa të marra		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(7,593,574)	(2,334,436)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë agjatgjata		(31,160,414)
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkrter		
Shtesa/pakesime në qera financiare	(2,309,938)	
Dividendë paguar		
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	(2,309,938)	(31,160,414)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(5,733,315)	77,670
Mjetet monetare në fillim të periudhës	11,335,261	11,257,591
Mjetet monetare në fund të periudhës	5,601,946	11,335,261

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 17, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ORION SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "ORION" shpk është regjistruar me 13 Maj 1998 ne Regjistrin e Shoqerive me vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr.38668 date 27.06.2007.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte ndertimi dhe importi i materialeve te ndryshme te ndertimit.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 39,000,000 leke i cili zoterohet nga ortakët : Z. Ardian Nelo dhe Alfred Nelo.

Administrator i shoqerise eshte Ardian Nelo.

Shoqëria është e regjistruar prane deges se Tatim Taksave ne Tirane me NIPT, J81715002Q. Selia qendrore e saj eshte ne « Rrugën e Kosovareve », Pallati Orion 2, prane Kompleksit Dinamo, Tirane.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrjnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

ORION SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Kurset e këmbimit		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flusit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe

ORION SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjëndjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.



ORION SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Makineri dhe Pasije	20%
Pajisje informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete Transporti	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.5 Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

ORION SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. MJETE MONETARE

Teprica e likuiditeteve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Vlera monetare në Lek	675,785	1,664,242
Banka	673,984	1,664,015
Arka	1,801	227
Vlera monetare në Valute	4,926,161	9,671,019
Banka	4,750,505	9,495,288
Arka	175,656	175,720
Totali	5,601,946	11,335,261

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë koston e punimeve të kryera së bashku me kostot shtese të investitorit për objektet e perfunduara në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Vlera e situacioneve me TVSH dhe kosto shtese Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	1,652,154,025	1,373,297,976
Totali	1,652,154,025	1,373,297,976

ORION SH.P.K.**Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lekë)***6. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA**

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

Ne kete ze jane paraqitur shpenzime per periudha te ardhshme dhe paradheniet per furnitore.

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime te periudhave te ardheshme	30,000	60,644,535
Totali	30,000	60,644,535

7. INVENTARI

Inventari më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Lende e pare dhe materiale te para	-	27,670,283
Inventar i imet	863,514	863,514
Mallra	14,107,555	-
Paradhenie per furnizime	315,731	661,377
Totali	15,286,800	29,195,174

8. LLOGARI TE TJERA TE ARKETUESHME

Balanca e llogarive te tjera te arketueshme me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Debitore te tjere	283,306	283,306
Totali	283,306	283,306



ORION SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

<i>Kosto</i>	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Pajisje informatike dhe teknike	Mobilije dhe Orendi	Te tjera AAM jomateriale	Totali
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	27,233,727	3,070,018	3,547,162	1,013,637	37,800	34,902,344
Shtesa		1,660,481	592,788	81,167		2,334,436
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	27,233,727	4,730,499	4,139,950	1,094,804	37,800	37,236,780
Shtesa	6,768,409		440,397	384,768		7,593,574
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	34,002,136	4,730,499	4,580,347	1,479,572	37,800	44,830,354
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	52,845	1,836,501	2,443,898	493,120	13,903	4,840,267
Amortizimi i vitit	1,359,044	490,529	351,393	111,509	3,585	2,316,060
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	1,411,889	2,327,030	2,795,291	604,629	17,488	7,156,327
Amortizimi i vitit	1,291,091	480,694	400,520	98,035	3,047	2,273,387
Nxjerrje jashtë përdorimit						
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	2,702,980	2,807,724	3,195,811	702,664	20,535	9,429,714
<i>Vlera neto kontabël</i>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	27,180,882	1,233,517	1,103,264	520,517	23,897	30,062,077
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	25,821,838	2,403,469	1,344,659	490,175	20,312	30,080,453
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	31,299,156	1,922,775	1,384,536	776,908	17,265	35,400,640

ORION SH.P.K.**Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lekë)***10. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE**

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te pagueshme ndaj furnitoreve	194,806,416	128,313,614
Totali	194,806,416	128,313,614

11. PARAPAGIME TE ARKETUESHME

Ne kete ze jane perfshire paradheniet e marra nga klientet per kontrata porosie per blerej apartamentesh, dyqanesh etj, gjendja e te cilave me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paradhenie nga kliente	899,837,043	783,781,097
Totali	899,837,043	783,781,097

12. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Detyrime per sigurime shoqerore & shendetesore	290,653	303,886
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat personale	116,084	124,245
TVSH per t'u paguar	2,280,770	525,715
Tatim fitimi	81,439	2,632,207
Te tjera tatime	1,000	
Totali	2,769,946	3,586,053

13. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA

Ne kete ze jane paraqitur detyrimet per pagat e personelit, detyrimi per pagimin e dividendit dhe kreditoreve te tjere si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Paga per t'u paguar	32,287	-
Dividend per tu paguar	219,840,068	37,448,752
Kreditore te tjere	23,197,384	204,701,731
Totali	243,069,739	242,150,483



ORION SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

14. KAPITALI

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 39,000,000 Leke.

Rezerva ligjore

Shuma prej 17,488,822 Leke perfaqeson rezervën ligjore me 31 Dhjetor 2014.

Rezerva te tjera

Shuma prej 288,206,698 Leke perfaqeson rezervat e tjera me 31 Dhjetor 2014.

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 23,578,053 Leke perfaqeson fitimin e vitit te mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

15. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga punimet, situacionet ne objekte	309,649,154	349,226,930
Te ardhura nga mbyllja e shitjeve te objekteve	253,590	205,525,698
Totali	309,902,744	554,752,628

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 janë në vlerën prej 309,902,744 Leke. Të ardhura të deklaruara në Drejtorinë Tatimore gjatë 2014 janë në vlerën prej 309,649,154 Lek. Ndryshimi prej 253,590 Leke perfaqeson te ardhura nga kontrolli tatimor.

	Dhjetor 31, 2014
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne	
Qarkullimi i tatueshem	309,649,154
Shtohen te ardhura nga kontrolli	253,590
Shuma e qarkullimit e korrektuar	309,902,744
Sipas Kontabilitetit	309,902,744
Diferenca	-

16. MATERIALE TE PARA DHE TE KONSUMUESHME

Kosto e materialeve te para dhe te tjera te konsumueshme per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Materiale dhe lende te para te konsumuara	252,399,542	285,291,491
Totali	252,399,542	285,291,491

ORION SH.P.K.**Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014***(Vlerat janë në Lekë)***17. SHPENZIMET E PERSONELIT**

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Shpenzime per paga	11,653,687	11,722,466
Shpenzime per sigurime shoq e shend	1,628,332	1,620,142
Totali	13,282,019	13,342,608

18. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Shpenzime amortizimi	2,273,387	2,316,060
Totali	2,273,387	2,316,060

19. SHPENZIME TË TJERA

Këto shpenzime janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Blerje Energji,avull,uje karburant	463,626	753,340
Blerje/shpenzime te tjera	1,009,913	440,407
Mirëmbajtje dhe riparime	1,451,570	1,360,053
Sigurime	-	10,748
Shpenzime qeraje	600,000	250,000
Trajtime te pergjitheshme	-	17,000
Sherbim I sigurimit dhe ruajtjes se objektit	2,160,000	2,016,000
Sherbime kontabiliteti dhe financiare	1,580,000	960,000
Sherbime konsulence	95,167	620,000
Transferime, udhetime dhe dieta	-	660,085
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	881,209	1,359,992
Komisione bankare	234,979	236,386
Taksa dhe tarifa vendore	400,146	1,245,262
Shpenzime per pritje dhe perfaqesim	371,770	360,170
Shpenzime te ndryshme te panjohura	1,900,236	1,897,089
Shpenzime transporti	2,658,948	
Te tjera		1,200,412
Totali	13,807,564	13,386,944

ORION SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

20. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare janë analizuar si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Shpenzime per interesa	(8,655)	
Te ardhura nga interesat	570	6,146
Humbje nga kembimet valutote	(585,057)	(4,088,304)
Te ardhura nga kembimet valutore	527,132	439,418
Totali	(66,010)	(3,642,740)

21. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Më 31 Dhjetor 2014	Më 31 Dhjetor 2013
Fitim i vitit përpara tatimit	28,074,222	236,772,785
Shpenzime te panjohura te tjera	1,900,236	1,897,089
Fitimi fiskal para tatimit	29,974,458	238,669,874
Shpenzime tatim fitimi	(4,496,169)	(23,866,987)
Fitimi pas tatimit	23,578,053	212,905,798

Rakordimi i normës efektive të tatimit mbi fitimin:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014	%	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013	%
Fitimi per vitin	28,074,222	100.00%	236,772,785	100.00%
Tatim fitimi me normen e aplikueshme	4,211,133	15.00%	23,677,278	10.00%
Shpenzime te panjohura	285,035	1.02%	189,709	0.08%
Totali	4,496,168	16.02%	23,866,987	10.08%

ORION SH.P.K.

Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

22. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

23. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Deklaruesi

ARDIAN NELO



Pengoat Pasqyrat Financiare
MIGENA HANA



Aktivitet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2014

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2014	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2014
1	Te tjera AA jo materiale	0	37,800	-	-	37,800
2	Ndertesa	0	27,233,727	6,768,409	-	34,002,136
3	Inst. Teknike, Makineri e Paisje	0	4,730,499		-	4,730,499
4	Mjete transporti	0	-		-	-
5	Paisje zyre dhe Informatike	0	4,139,950	440,397	-	4,580,347
6	Mobilje dhe Orendi	0	1,094,804	384,768	-	1,479,572
	TOTALI	0	37,236,780	7,593,574		44,830,354

Amortizimi A.A.Materiale 2014

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 31/12/2014	Shtesa	Pakesime	Gjendje 31/12/2014
1	Te tjera AA jo materiale	0	17,488	3,047	0	20,535
2	Ndertesa	0	1,411,889	1,291,092	0	2,702,981
3	Inst. Teknike, Makineri e Paisje	0	2,327,030	480,694	0	2,807,724
4	Mjete transporti	0	-		0	-
5	Paisje zyre dhe Informatike	0	2,795,292	400,520	0	3,195,812
6	Mobilje dhe Orendi	0	604,629	98,035	0	702,664
	TOTALI		7,156,328	2,273,387		9,429,715

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2014

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 01/01/2014	Shtesa	Pakesime Amortizimi vjetor	Gjendje 31/12/2014
1	Te tjera AA jo materiale	0	20,312	-	3,047	17,265
2	Ndertesa	0	25,821,839	6,768,409	1,291,092	31,299,156
3	Inst. Teknike, Makineri e Paisje	0	2,403,469		480,694	1,922,775
4	Mjete transporti	0	0			0
5	Paisje zyre dhe Informatike	0	1,344,658	440,397	400,520	1,384,535
6	Mobilje dhe Orendi	0	490,175	384,768	98,035	776,908
	TOTALI		30,080,453	7,593,574	2,273,387	35,400,640

Administratori

- Ardian NELO

(Handwritten signature: Ardian Neelo)

ORION SH.P.K.
NIPT J81715002Q

Inventari i automjeteve ne pronesi te subjektit 31.12.2014

Nr.	Lloji i automjetit	Kapaciteti	Targa	Vlera (leke)
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
etj				
			TOTAL	0

Deklaruesi

Ardian NELO

Ardian NELO

ORION
SH.P.K.

ORION SHPK 2014

NIPT J81715002Q

Inventari gjendje ne daten 31.12.2014

Kodi	Pershkrimi i Materialit	Njesia matese	Sasi	Cmim	Vlefte
B0016	Brisole (Derrase e pjerrët) 105x495x47	M2	16.52	17750.19	293,233.1
B0017	Brisole trekendore 51x495x47	COP	2152	911.29	1,961,104.3
B0019	Brisole trekendore 51x495x47 per moster	COP	4.00	151.63	606.5
D0011	Dyer te brendshme tamburato	COP	37.00	13497.64	499,388.5
L0001	Lende druri	M3	21.06	38457.84	809,922.2
S0013	Skela	M2	5350.3581	1968.86	10,534,121.5
T0007	Tulla 20x25x25	COP	38.60	39.20	1,513.0
T0008	Tulla 10x25x25	COP	319.90	23.97	7,666.7
	Totali i Vleres se inventarit		7,939.44	72800.61	14,107,555.77

ADMINISTRATORI

ARDIAN NELO

Arduan Nelo
Shkup
 20.12.2014
 SHPK